Riciklimi mbetet si gjithnjë një ndër sfidat kryesore dhe prioritetive të punës sonë. Janë realizuar fushata dhe aktivitete të shumta sensibilizimi në shkolla, biznese private dhe institucione shtetërore, të cilat në vetëvehte kanë shprehur rritje të ndërgjegjësimit për këtë proces, të selektimit dhe ndarjes në origjinë të mbetjeve urbane. Mendojmë që kjo punë duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen, për ti paraprirë dhe zbatimit të VKM nr 418 datë 25.06.2014 të cilat kanë përcaktuar afate kohore (vitin 2016) për njësitë e mëdha të qeverisjes vendore, për vënien në efikasitet të plotë të "Grumbullimit të diferencuar të mbetjeve në burim".

2. Shërbimi i Mirëmbajtjes së Sipërfaqeve të Gjellbërta

Shërbimi i mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjellbërta kryhet me sipërmarrje, në zbatim të kontratës 5-vjeçare të lidhur që në Tetor të 2013 dhe aneks-kontratave të hartuara për 2015. Në preventivat e hartuar për shërbimin e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjellbërta janë kryer këto shërbime. Plani i miratuar në buxhetin për vitin 2015 për këtë shërbim është 30 770 000 lek.

- Shërbimi i mirëmbajtjes së lulishteve është kryer në një sipërfaqe prej 66 mijë m², ku për çdo 1000 m² lulishte përfshihen: bar i kultivuar 450 m², sipërfaqe lulesh 250 m², sipërfaqe rruge në lulishte 300 m² si dhe mirëmbajtje drurë dekorativ, shkurre dekorative e bordure të gjellbërta. Janë kryer shërbimet e plota

edhe në sipërfaqet e rikonstruara vitet e fundit, me të gjithë elementët e saj. Përveç tyre në sipërfaqet e tjera të gjelberta që nuk kanë këto elementë janë kryer shërbime të pjeshme në mirëmbajtje.

- Mirëmbajtje e drurëve dekorativ, që përfshin mirëmbajtjen e drurëve dekorativ të gjelbërimit rrugor, veç lulishtave. Në preventivin e hartuar përfshihen proceset e krasitjes së tyre, vaditjes, prashitjes si dhe plehërimit për një zhvillim sa më të mirë. Sipas inventarit rezultojnë 4020 drurë dekorativ në rrugët kryesore të qytetit.
- Mirëmbajtja e shkurreve dekorative prej 800 copë përfshin mirëmbajtjen e shkurreve dekorative nëndarëse te rruga “Mehmet Pashe Plaku”.
- Në zërin “Mbjellja e drurëve, shkurreve dhe bordurave të gjelbërta” u parashikua dhe u krye zëvendësimi i tyre nga tharjet dhe dëmtimet e pakthyeshme në lulishta, si dhe plotësimi i gjelbërimit rrugor.
- Në zërin “Mirëmbajtje sipërfaqe ujore” prej 650 m2 përfshihen punimet e mirëmbajtjes së shatërvanit në lulishten e Parrucës, shatërvani Sheshi Demokracia. Punimet që përfshihen janë pastrimi, larja e tyre çdo muaj, si dhe riparimi i pompave dhe elektropompave në raste të difekteve.

Në zërin “Mirëmbajtje shkurre dekorative” futen 250 copë në vazo të mëdha të mbjellura me shkurre. Këto ndodhen kryesisht në hyrjen e qytetit tonë si dhe në Pedonalen e Piacës. Në preventiva është llogaritur prashitja, vaditja, mirëmbajtja e vazove si dhe ndonjë zëvendësim të bimëve të dëmtuara.

Pasqyra e shpenzimeve për shërbimin e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta për Bashkinë Qytet në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Plani 2015	Realizimi 2015
1	Paga	614	576
2	Sigurime shoqërore	98	97
3	Shpenzime operative	30 770	30 770
SHUMA		31 482	31 443

3. Shërbimi i Mirëmbajtjes së Varrezave Publike dhe Dëshmorëve

Realizimi i këtij shërbimi kryhet me sipërmarrje, në bazë të kontratës bazë të lidhur me 01. 07. 2013, kontratë 5-vjecare dhe të aneks – kontratave të lidhura për vitin 2015. Është kryer në përputhje me preventivat dhe specifikimet teknike, ku janë kryer këto shërbime:

-Mirëmbajtje parcela varrezash dhe rrugëve brenda tyre.

-Mbjellë bordura të gjelbërta në parcela të reja si dhe drurësh dekorativ në këto parcela.

Pasqyra e shpenzimeve sipas thesarit për shërbimin e mirëmbajtjes së varrezave publike dhe dëshmorëve për Bashkinë Qytet në mijë lekë

Nr	Emërtim	Plani 2015	Realizimi 2015
1	Paga	128	120
2	Shpenzime shoqërore	21	21
3	Shpenzime operative	7 206	7 206
SHUMA		7 355	7 347

Gjatë këtij viti janë realizuar shërbime cilësore sipas zërave të mësipërm për Mirëmbajtjen e Varrezave Publike dhe Dëshmorëve, si dhe ruajtjen e tyre.

4. Mirëmbajtje Rrugë e Trotuare në Qytet

Ky shërbim realizohet me kontratë 5 vjeçare. Për vitin 2015 është lidhur aneks kontrata prej 3 697 mijë lekë dhe janë realizuar punimet në bazë të preventivit të detajuar sipas vlerësimit teknik të gjendjes së rrugëve dhe trotuareve. Për vitet e tjera brenda vlerës së përgjithshme të kontratës do të hartohen aneks kontratat në përputhje me vlerësimin e gjendjes teknike në periudhat përkatëse.

Pasqyra e shpenzimeve sipas thesarit për mirëmbajtje rrugë e trotuare për Bashkinë Qytet në mijë lekë

Nr	Emërtimi i punimeve	Plani 2015	Realizimi 2015
1	Shpenzime operative	3 697	3 695
SHUMA		3 697	3 695

Gjatë vitit 2015 janë realizuar punimet për riparimin e rrugëve më të amortizuara. Në këto raste është ndërhyrë në mbylljen e gropave me të gjithë nënshtresat e shtresat asfaltike, si dhe në riveshjen e një pjese të rrugëve të dëmtuara si shtresë punuese.

Një vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe riparimit të trotuareve. Kryesisht është ndërhyrë në trotuaret që kanë qenë me amortizim më të madh ose që kanë pësuar dëmtime ose shembje të tyre.

Po ashtu është punuar në ngritje dhe riparime të pusetave të dëmtuara në rruge, si dhe riparimi i kunetave e bordurave.

5. Ndrëçim rrugor

Pasqyra e shpenzimeve për ndrëçimin rrugor për Bashkinë Qytet në mijë lekë

Emërtimi i shpenzimeve	Plani i vitit 2015	Realizimi 2015
------------------------	--------------------	----------------

Nr			
600	Paga	2 149	2 277
601	Sigurime shoqërore	342	380
602	Shpenzime operative	45 203	43 984
606	Kompens. punonjësish	48	6
Shuma		46 573	46 647

1. Zërat **Paga** dhe **Sigurime Shoqërore** është realizuar në shumën **2 277 mijë** dhe **380 mijë** lekë.

2. Zëri Shpenzime Operative përbëhej nga dy pjesë:

a. Materiale e shërbime speciale.

Për zërin Materiale e shërbime speciale kanë qenë planifikuar për t'u shpenzuar 4 560 mijë lekë. Ky shpenzim ishte parashikuar për blerjen e materialeve elektrike për mirëmbajtjen e rrjetit së ndriçimit ekzistues të qytetit me një sipërfaqe prej 531 000 m² rruge, sheshe e lulishte. Për zërin materiale e shërbime speciale realizimi për vitin 2015 është 4 018 mijë lekë. Janë kryer të gjitha procedurat për blerjen e këtyre materialeve. Me këto shpenzime është siguruar baza materiale e nevojshme për mirëmbajtjen në efikasitet të rrjetit të ndriçimit publik.

b. Shërbime ku përfshihen kryesisht shpenzimet për energjinë elektrike.

Për zërin Shërbime, në buxhetin 2015 janë parashikuar shpenzimet për energjinë elektrike në shumën 40 643 mijë lekë. Me këtë fond është realizuar shlyerja e faturave të energjisë elektrike deri në fund të vitit 2015 me vlerë 39 966 mijë lekë.

Njësitë e reja Administrative

Nj.A Gur i Zi nga data 21 gusht deri në dhjetor ka realizuar shpenzime të energjisë elektrike për ndriçimin rrugor me vlerë prej **154 177 lekë**

Nj.A Dajç nga data 21 gusht deri në dhjetor ka realizuar shpenzime të energjisë elektrike për ndriçimin rrugor me vlerë prej **328 291 lekë**

Nj.A Ana e Malit nga data 21 gusht deri në dhjetor ka realizuar shpenzime të energjisë elektrike për ndriçimin rrugor me vlerë prej **304 611 lekë**

Nj.A Velipojë nga data 21 gusht deri në dhjetor ka realizuar shpenzime të energjisë elektrike për ndriçimin rrugor me vlerë prej **302 638 lekë**

Nj.A Postribë nga data 21 gusht deri në dhjetor ka realizuar shpenzime të energjisë elektrike për ndriçimin rrugor me vlerë prej **107 641 lekë**

Nj.A Shalë nga data 21 gusht deri në dhjetor ka realizuar shpenzime të energjisë elektrike për ndriçimin rrugor me vlerë prej **15 354 lekë**

- **Sinjalistikë – Dekor**

Pasqyra e shpenzimeve për sinjalistikë- dekor për Bashkinë Qytet në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i shpenzimit	Plani i vitit 2015	Realizimi 2015
600	Paga	742	696
601	Sigurime Shoqërore	118	117
602	Shpenzime operative	3 050	2581
606	Kompen. punonjësish	12	
Shuma		3 922	3 394

1. Zërat **Paga** dhe **Sigurime Shoqërore**. Për vitin 2015 kanë qenë planifikuar respektivisht **742 mijë lekë** dhe **118 mijë lekë**. Realizimi i këtyre dy zërave për vitin 2015 ka qenë **696 mijë** dhe **117 mijë lekë**.
2. Zëri **Shpenzime Operative**. Për vitin 2015 janë parashikuar **3 050 mijë lekë** të ndara në:
 - a. Sinjalistikë 2 350 mijë lekë
 - b. Dekorim qyteti 700 mijë lekë

Për zërin materiale e shërbime speciale "Blerje materiale për sinjalistikën" (horizontale + vertikale) realizimi për vitin 2015 është 1 893 mijë lekë. Me këto materiale të blera janë realizuar vijëzimi i rrugëve, vijëzime këmbësorësh, korsitë biçikletash, vendqëndrime autobusësh urban si dhe janë vendosur tabela të llojeve të ndryshme.

Dekori i qytetit, gjatë vitit 2015 është realizuar blerja e bredhave për zbukurimin e qytetit për festat e fundvitit me vlerë 120 mijë lekë, gjithashtu dhe blerja e aksesorëve zbukurues me vlerë 568 mijë leke. Zbukurimi i qytetit është realizuar edhe me aksesorë të investuar në vite.

- **Mobiliteti (lëvizshmëria urbane)**

Në kuadër të Lëvizshmërisë (Mobilitetit) të qëndrueshme urbane, Bashkia Shkodër ka filluar investime direkte që ndikojnë në qetësimin e trafikut dhe krijimin e infrastrukturave lehtësuese për përdorimin e biçikletave.

- **Ndërtim e rikonstruksion ndërtim Sinjalistikë Horizontale (bumpe), me vlerë 1 537 mijë lekë**

Ky objekt nuk është realizuar

- **Vendqëndrime për biçikleta me vlerë 1 178 mijë lekë**

Ky objekt nuk është realizuar

- **Transporti Urban**

Gjatë vitit 2015 shërbimi i transportit urban është kryer në dy linjat Bahçallëk-Fermentim-Bahçallëk dhe Qendër-Shiroke-Zogaj e kthim. Nga shtatori i vitit 2012 ky shërbim kryhet me operator privat.

Shërbimi është realizuar sipas kontratës duke siguruar numrin e nevojshëm të automjeteve të planifikuar për kryerjen e këtij shërbimi me cilësi shumë të mirë duke krijuar kushte të mira për udhëtim për të gjitha stinët e vitit.

Drejtoria e shërbimeve publike dhe sektori i transportit ka ushtruar kontrole të vazhdueshme dhe monitorime për të bërë të mundur që ky shërbim të jetë sa më eficient dhe të plotësojë sa më mirë kërkesat dhe nevojat e komunitetit si dhe të shohë mundësitë e përmirësimit të mëtejshëm të këtij shërbimi duke evidentuar edhe nevojat e kërkesat e operatorit që punon në këtë shërbim.

Bashkia Shkodër ka realizuar sinjalistikën e nevojshme për të mbështetur realizimin e qarkullimit normal, si dhe tabelat në stacione për informacion për oraret e lëvizjes e të shërbimit, frekuencat etj.

Në mbështetje të VKM Nr. 637 datë 21. 05. 2008 për tarifën e transportit urban, Ligjit Nr. 9374 datë 21.04.2005 "Për ndihmën shtetërore", referuar KNSH (Komisioni i ndihmës shtetërore) Nr. 26 datë 17.06.2008 "Për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik" Këshilli Bashkiak me Vendimin Nr. 5 datë 31. 01. 2014, ka bërë të mundur që për vitin 2015 të bëhet subvencionimi social për 600 abone për periudhën janar-mars ndërsa prill-qershor dhe shtator- dhjetor 800 abone në muaj.

Subvencionimi ka qenë i parashikuar në vlerën 1 200 lekë për çdo biletë pajtimi njëpërdorimëshe, ku vlera e subvencionit ka qenë 9 120 mijë lekë. Për vitin 2015 Bashkia Shkodër ka subvencionuar për 10 muaj operatorin në vlerën 8 880 mijë lekë.

INVESTIME

Rikonstruksion rrugë dytësore

Për vitin 2015, janë realizuar investimet për rikonstruksionin e rrugëve dytësore të qytetit sipas prioriteteve të rajoneve dhe Bashkisë Shkodër.

Për grupin I - me vlerë 18 987 mijë lekë janë realizuar:

- Rikonstruksion Rruga mbrapa Zyres Punes
- Rikonstruksion Rruga në krah të Drejtorisë së Bujqësisë + tek Shkolla Natës
- Rikonstruksion Rruga Ramadan Sokoli
- Rikonstruksion Rruga Aradas
- Rikonstruksion trotuari Rruga Haxhi Idriz Boksi
- Rikonstruksion Rruga Dashej

Me fondin e programuar janë mbuluar shpenzimet e sipërmarrjes së zbatimit, të mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve. Punimet kryesore që janë realizuar

konsistojnë në sistemimin dhe asfaltimin e këtyre rrugëve, në ndërtimin e linjave të ujësjellësit, ndërtimi i KUB dhe ndërtimi i KUZ, vendosjen e bordurave dhe sistemimin e kunetave.

Për grupin II me vlerë 17 347 mijë lekë janë realizuar:

- Rikonstruksion Rruga Shefqet Muka
- Rikonstruksion Rruga Cenaj
- Rikonstruksion Rruga Qendresa 1920
- Rikonstruksion Rruga Dëshmorët 1912-13
- Rikonstruksion Rrugice Nazmi Kryeziu
- Rikonstruksion Segment Rruga Dr. Ali Spahija
- Ndertim xhep kazani ne hapesiren e trotuareve

Me fondin e programuar janë mbuluar shpenzimet e sipërmarrjes së zbatimit, të mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve. Punimet kryesore që janë realizuar konsistojnë në sistemimin dhe asfaltimin e këtyre rrugëve, në ndërtimin e linjave të ujësjellësit, ndërtimi i KUB dhe ndërtimi i KUZ, vendosjen e bordurave dhe sistemimin e kunetave

Për grupin III me vlerë 16 196 mijë lekë janë realizuar:

- Rikonstruksion Rruga Gjon Destanishtaj
- Rikonstruksion Rruga Kuklej
- Rikonstruksion Rruga Karl Gurakuqi
- Rikonstruksion Rruga Dr. Todi
- Rikonstruksion Rruga Kel Kodheli
- Rikonstruksion Rruga At Martin Gjoka
- Rikonstruksion Rrugice te fusha lekurës
- Rikonstruksion Rruga Rinia

Me fondin e programuar janë mbuluar shpenzimet e sipërmarrjes së zbatimit, të mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve. Punimet kryesore që janë realizuar konsistojnë në sistemimin dhe asfaltimin e këtyre rrugëve, në ndërtimin e linjave të ujësjellësit, ndërtimi i KUB dhe ndërtimi i KUZ, vendosjen e bordurave dhe sistemimin e kunetave

Për grupin IV me vlerë 17 003 mijë lekë janë realizuar:

- Rikonstruksion Rrugica tek Mehmet Pashe Plaku
- Rikonstruksion Rruga Ahmet Efendi Kalaja
- Rikonstruksion Rruga Danej
- Rikonstruksion rruga At Donat Kurti segmenti II
- Rikonstruksion Rruga te shkolla 3 Dhjetori
- Rikonstruksion Rruga degëzim Banja e Vogël
- Rikonstruksion Segment Rruga Kol Kamsi

Me fondin e programuar janë mbuluar shpenzimet e sipërmarrjes së zbatimit, të mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve. Punimet kryesore që janë realizuar konsistojnë në sistemimin dhe asfaltimin e këtyre rrugëve, në ndërtimin e linjave të ujësjellësit, ndërtimi i KUB dhe ndërtimi i KUZ, vendosjen e bordurave dhe sistemimin e kunetave.

Sistemim Blloqe Banimi me vlerë 19 322 mijë lekë

- Sistemim blloqe banimi te Vasiejt (Qafhardhi)
- Sistemim Blloqe Banimi Isuf Sokoli
- Rikonstruksion Lulishte te Cerciz Topulli
- Sistemim blloqe banimi Mark Lula segmenti I
- Sistemim blloqe banimi te 7 Shalianet (Tepe)

Me anë të VKB nr 36 datë 09.11.2015 “Për rishpërndarje fondesh të buxhetit të Bashkisë Shkodër viti 2015” ky investim nuk është realizuar

Rikonstruksion Degëzim rruga Pal Ëngjëlli me vlerë 735 mijë lekë

Me Urdhërin nr 32 datë 27.08.2015 janë rialokuar fonde për realizimin e këtij investimi. Me fondin e programuar janë realizuar shpenzimet e sipërmarrjes së zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve për rikonstruksionin e rrugës. Janë kryer punimet në kanalizimin e ujrave të bardha dhe asfaltim.

Rikonstruksion ndriçimi me vlerë 8 403 mijë lekë.

- ***Ndërtim linja e ndriçimit rruga Gjovalin Gjadri me vlerë 5 385 mijë lekë***

Me fondin e programuar janë mbuluar shpenzimet e sipërmarrjes së zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve për ndriçimin e linjës gjatë rrugës Gjovalin Gjadri. Ndriçimi është bërë nga të dy anët e rrugës me shtylla dhe ndriçuesat rrugore.

- ***Rikonstruksion ndriçimi lulishtja Vaso Kadia me vlerë 597 mijë lekë***

Me fondin e programuar janë mbuluar shpenzimet e sipërmarrjes së zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve për ndriçimin e kësaj lulishte. Punimet kryesore ishin ndërhyrja në rikonstruksionin e rrjetit elektrik.

- ***Rikonstruksion ndriçimi rrugë dytësore me vlerë 2 421 mijë lekë.***

Me fondin e programuar janë mbuluar shpenzimet e sipërmarrjes së zbatimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve për ndriçimin e rrugëve dytësore, kryesisht ato të rikonstruktura. Punimet kryesore të kryera janë rikonstruksioni i rrjetit ekzistues e shtrirje e rrjetit të ri dhe vendosje ndriçuesish.

Të ndryshme

- ***Sistemim ambjenti varreza publike me vlerë 1 372 mijë lekë***

Ky investim nuk është realizuar, pasi nuk është kryer procedura e shpronësimit të sipërfaqes ku do të realizohej investimi.

- **Rikonstruksion varrezat e dëshmorëve (shtesë) me vlerë 160 mijë lekë**

Ky investim nuk është realizuar

- **Blerje kazana metalike dhe kosha mbeturinash me vlerë 3 872 mijë lekë**

Me qëllimin për të plotësuar vend-depozitimeve të reja që krijohen nga vete qytetarët jashtë atyre pikave të përcaktuara deri tani, është bërë blerja e kazana metalike dhe kosha mbeturinash. Gjendja e atyre ekzistuese si në sasi ashtu dhe në cilësi nuk ishte e mjaftueshme. Për këtë kemi shtuar numrin me 100 copë kazaneve metalike me volum 1100 litërsh dhe diferenca prej 600 mijë lekë është përdorur për blerje kosha mbeturinash të llojeve të ndryshme për zëvendësim në shëtitoren e qytetit etj.

- **Blerje vinç me kosh me vlerë 2 256 mijë lekë**

Me fondin e programuar janë realizuar shpenzimet për blerjen e nje vinçi me kosh për shërbimet e mirëmbajtjes së ndriçimit rrugor dhe dekorit të qytetit.

- **Blerje Trafik ndarës para bashkisë me vlerë 300 mijë lekë**

Ky investim nuk është realizuar.

- **Ndërtim Sinjalistikë Horizontale (bumpe me vija të bardha), me vlerë 2 200 mijë lekë**

Ky investim nuk është realizuar.

- **Hidroizolim terrace garazhi të Bashkisë me vlerë 168 mijë lekë**

Këto garazhe janë dhe magazina për punonjësit tanë të sinjalistikës. Gjendja e tyre ishte mjaft e amortizuar dhe ishte e domosdoshme ndërhyrja për hidroizolim e tarracës. Me realizimn e këtij investimi, gjëndja e objektit është kthyer në kushte optimale pasi ujërat e shiut nuk depërtojme më.

- **Rikonstruksion KUZ rruga Gurazezëve dhe shkolla Xheladin Fishta planifikuar me vlere 2 500 mijë lekë**

Me Urdhërin e Brendshëm nr 159 prot datë 19.08.2015 “Ridetaim i buxhetit të programit 6330, artikulli 231 për vitin 2015”, ky investim është ndarë në dy pjesë. Objekti “Rikonstruksion KUZ rruga Gurazezëve” me vlerë 1 864 mijë lekë janë mbuluar shpenzimet e sipërmarrjes së zbatimit, të mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të rindërtimit të KUZ.

Objekti “Rikonstruksion KUZ shkolla Xheladin Fishta” me vlerë 636 mijë lekë, nuk është realizuar.

- **Rikonstruksion KUB lidhja kolektori perash – unaze me vlerë 2 500 mijë lekë**

Është realizuar lidhja e kontratës, punimet nuk kanë filluar për arsye teknike

- **Vendqëndrime dhe stenda për parkim biçikletash me vlerë 1 200 mijë lekë**

Ky investim nuk është realizuar.

BASHKËFINANCIME

Rrethim metalik dekorativ për pemët e zonës Bid me vlerë 178 mijë lekë

Ky investim është financuar 50% me fondet e Bashkisë e 50% nga BID. Me këtë investim u realizua rrethimi metalik dekorativ i pemëve të rrugës pedonale “13 Dhjetori” – “28 Nëntori”

Rikualifikim urban i rrugicave në qendren historike sheshi gjon Pali i II-të me vlerë 15 881 mijë leke.

Ky investim është realizuar me fonde të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve. Punimet për këtë objekt kanë përfunduar dhe janë realizuar punimet për rikualifikimin e sheshit kryesor të Kishës së Madhe dhe rrugës Marin Biçikemi. Me këto fonde është realizuar sistemimi i sheshit me gurë dekorativ, vendosja e ndriçuesave të rinj dhe rindërtimi i KUB.

Rikualifikim urban i rrugicave në qendren historike me vlerë 43 877 mijë lek

Ky investim është realizuar me fonde të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve. Punimet për këtë objekt janë në vazhdim. Punimet për rikualifikimin urbane të këtyre rrugicave konsistojnë në sistemimin e rrugicave historike me gurë dekorativ, vendosja e ndriçuesave të rinj dhe rindërtimi i KUB.

Rikualifikimi urban i ambienteve të jashtme të katedrales së Shën Shtjefnit me vlerë 15 852 mijë leke

Ky investim është realizuar me fonde të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve. Punimet për këtë objekt kanë përfunduar dhe janë realizuar punimet për rikualifikimin e sheshit kryesor të katedrales së Shën Shtjefnit. Me këto fonde është realizuar sistemimi i sheshit me gurë dekorativ, vendosja e ndriçuesave të rinj dhe rindërtimi i KUB.

Ndërtim i kanalizimit të ujrave të bardha dhe të zeza, dalja shinat e trenit - lumi Kir me vlerë 23 030 mijë lekë

Ky investim është miratuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës. Për këtë objekt ka filluar realizimi i punimeve. Pritet çelja e fondeve nga Ministria e Financave për vitin 2016.

Aktiviteti i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit bazohet ndërmjet të tjerave , në ligjin specifik atë nr 107/2014 „ Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit“ Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 502 date 13.07.2011 “ Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit dhe zhvillimit të territorit “ (i ndryshuar) , Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr 14 datë 04.07.2013 për „ Miratimin e Instrumentave të Pergjithshëm Vendor të Bashkisë Shkoder, , Vendimet e Keshillit Kombëtar të Territorit nr 1 datë 22.08.2014 , nr 8 datë 07.11.2014 dhe nr 5 datë 29.12.2014 si edhe VKM nr 408 datë 13.05.2015 „ Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit“

Një ndër detyrat kryesore funksionale të Drejtorisë kanë qënë zhvillimet në territor. Zhvillimet ne Territor gjatë periudhës që raportohet Janar- dhjetor 2015 , kanë qënë zhvillime të planifikuara ne Instrumentin e Planifikimit të Territorit. Zhvillimet ne Territor jane kryer nga Zhvillues private dhe Zhvillues publike. Ne rastin e Zhvillimeve te kryera nga zhvilluesit publike hyjne te gjitha investimet e kryera me fonde të Buxheti Lokal dhe ato te kryera me fonde nga Buxheti I Shtetit nëpërmjet Fondit të Zhvillimit të Rajoneve.

Gjatë vitit 2015 në bashkëpunim me Agjensinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit , janë dhënë gjithësej 22 Leje Ndërtimi/Zhvillimi.

Nga këto 11 janë Leje Ndërtimi për investme publike me një vlerë investimi në total prej 442.585.498 lekë , prej të cilave 148.358.000 lekë janë investime nga Buxheti Lokal dhe 294.227.498 lekë jane nga Buxheti I Shtetit nëpërmjet Fondit të Zhvillimit të Rajoneve dhe Fondit Shqiptar tq Zhvillimit. Vlerën më të madhe të këtij investimi e zë “ Muzealizimi I Fototekës Kombëtare Marubi” me një fond prej 166.000.000 lekë.

Për investime private janë dhënë 11 leje Ndërtimi/zhvillimi të gjitha mbas marrjes së konformitetit nga Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe botimi në regjistrin elektronik kombëtar të territorit. Vlera e investimit privat për këto investime kap vlerën e 106.039.835 lekë.

Përvec Lejeve të Zhvillimit/Ndërtimit , bazuar në dispozitat ligjore janë dhënë rreth 118 Deklarime Paraprake Punimesh , të cilat kanë të bëjnë kryesisht më punime mirëmbajtje si lyerje, riparime suvatimesh, zëvendësim dyer apo dritare , shtrime me pllaka të brendëshme apo oborresh.

Pjesë e detyrimit ligjor është edhe dhënia e lejeve të shfrytëzimit (certifikata e përdorimt) për objektet të cilat kanë perfunduar dhe janë kolauduar.

Gjatë vitit buxhetor 2015 janë përpunuar dhe dërguar për regjistrim në zyrën e regjistrimit te pasurive te paluajtëshme 28 objekte. Prej te cilave 4 objekte multifamiljare, dhe 24 objekte - banesa njëfamiljare, rikonstruksione apo edhe adoptime banesash në njësi shërbimi.

Për vitin 2015 nga juristi i Drejtorisë është realizuar mbrojtja gjyqësore e disa çështjeve relative me detyrat që realizohen në bazë të ligjit .

Numri i çështjeve gjyqësore të përfaqësuara është gjithsej 14 çështje gjyqësore, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit si lëshim urdhri ekzekutimi , kundërshtim i veprimeve përmbarimore apo kontestime për çështje pronësie, nga të cilat:

- Aktualisht janë në proces gjykimi pranë Gjykatës administrative të shkallës së parë rreth 9 çështje administrative,
- 2 në proces gjykimi pranë Gjykatës së Apelit, dhe
- 3 çështje për gjykim në Gjykatë të Lartë.

Gjatë vitit 2015 janë përpunuar në total rreth 1650 shkresa zyrtare prej te cilave 420 korespondence me institucione publike, dhe rreth 1230 pergjigje me qytetaret.

Pjese e punes ka qene edhe hartimi i projekt-preventivave per investimet publike te realizuara me fonde te buxhetit Lokal. Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit janë përgatitur projekt-preventivat dhe dokumentacioni i gatshëm për procedurë tenderi për 31 projekte për objekte kryesisht rehabilitim rrugë dytësore dhe sistemim blloqe banimi.

Mbledhja e taksës së ndikimit në infrastrukturë për vitin 2015 ka qënë në masën 48.067.000 lekë parashikimi ka qënë në masën 40.000.000 lekë. Tarifat për shërbime të tjera janë realizuar në masën 1.255.000 lekë.

DREJTORIA BURIMEVE NJERËZORE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Misioni i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse është rritja e performancës së menaxhimit të burimeve njerëzore , harmonizimi më i mirë i strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale të Bashkisë, me qëllim përmbushjen e misionit të administratës së Bashkisë së Shkodrës në realizimin e qëllimeve dhe objektivave për të menaxhuar me transparencë dhe efektivitet, për të ofruar shërbim më të mirë ndaj publikut, nëpërmjet menaxhimit efektiv të burimeve financiare, materiale dhe njerëzore, rritjes së transparencës së

shërbimeve dhe ngritjes së kapaciteteve menaxhuese, për të përballuar me profesionalizëm sfidat në përmbushjen e detyrimeve ndaj komunitetit .

Kjo drejtori ka mbuluar edhe nevojat për shpenzimet operative për administratën e Bashkisë dhe institucionet e varësisë ku përfshihen: Teatri, Dega Ekonomike e Kulturës, Sportklub “Vllaznia”, Zyra e Arsimit (shkollat 9 vjeçare, të mesme, konviktet e sistemit parauniversitar, kopshtet) si dhe Drejtoria e Çerdheve .

000/leke

Nr	EMERTIMI	Plani 2015	Realizimi 2015
I	Paga	131 547	104 749
II	Sigurime Shoqërore	21 439	17 450
III	Shpenzime Operative	54 697	30 483
IV	Investime	1 170	911
Totali		208 853	153 593

Shpenzimi për « **Paga** » për vitin 2015 është realizuar vlera prej **104 749 mije leke**, duke përfshirë këtu dhe pagat për punonjësit e njësive administrative paguar pas reformës territoriale si dhe planin e transferuar nga Njesitë Administrative , për « **Sigurime shoqërore** » vlera prej 17 450 **leke** ku njësorj si për paga, janë të përfshira plani e fakti për njësitë administrative pas bashkimit, për « **Shpenzime operative** » vlera prej **30 483 mije leke** dhe për « **Investime** » vlera prej **911 mije lekë**.

Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli është bazuar tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë , në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Paga, shtesat mbi pagat e punonjësve janë bërë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1619, datë 02.07.2008, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, ndryshuar me V.K.M Nr.518, datë 16.08.2012, ndryshuar me VKM Nr. 586, datë 17.07.2013.

Shpenzime operative



000/leke

Nr	Emertimi i shpenzimeve	Plani 2015	Realizimi 2015
6020	Materiale e sherb. zyre te pergjith.	3,655	3,431
6021	Materiale dhe sherbime speciale	850	344
6022	Sherbime	13,363	10,132
6023	Shpenzime transporti	5,430	5,380
6024	Shpenzime udhetimi	150	41
6025	Mirmbajtje e zakonshme	600	320
6026	Qera objekteve	60	60
6027	Detyrime dhe kompensime legale	19,880	1
6029	Shpenzime te tjera operative	10,709	10,483
Totali		54,697	30 192

Më poshtë është analiza e shpenzimeve sipas grupeve dhe në mënyrë analitike:

“Materiale e shërbime zyre të përgjithshme” realizimi për vitin 2015 është në vlerën

3 431 mijë leke i detajuar si më poshtë:

- ✓ Zëri **“Kancelari”** është realizuar në vlerën prej **1 555 mijë lekë**. Këto shpenzime janë realizuar për të mbuluar kërkesat e drejtorive të administratës së Bashkisë, Teatrit, Degës Ekonomike të Kulturës, Sportklub “Vllaznia” dhe shkollave të mesme , shkollave 9-vjecare, arsimit parashkollor, konvikteve të shkollave të mesme, të planifikuara këto nga Zyra e Arsimit.
- ✓ Zëri **“Materiale për pastrim, dizinfektim”**, i parashikuar për blerje materiale pastrimi për krijimin e kushteve bashkëkohore me standarte të larta nëpërmjet sigurimit të ambjenteve të përshtatshme, të pastra dhe me mjetet e nevojshme për pastrim të ambjenteve si për administratën ashtu edhe institucionet e varësisë : Teatri, Dega Ekonomike e Kulturës, ”, Zyra e Arsimit (shkollat 9 vjeçare, të mesme, konviktet e sistemit parauniversitar, kopshtet) si dhe Drejtoria e Çerdheve është realizuar në vlerën **1 794 mijë lekë**.
- ✓ Zëri **“Blerje dokumentacioni “** është realizuar në vlerën prej **82 mijë lekë** për blerje shtypshkrime për nevoja të institucioneve të varësisë dhe administratës së bashkisë si prodhime blloqe fletëhyrje-dalje, mandat pagesë-arketime, rregjistra themeltarë e të tjera të këtij lloji si edhe shtypshkrime të tjera, të cilat janë porositur në “Shtypshkronjën e

Letrave me Vlerë Sh a ” mbështetur në VKM Nr.393 datë 18.06.2014 (procesverbale konstatimi kundravajtjesh, vendime për pezullimin e punimeve, vendime për dënime me gjobë ,vendim për prishje objekti , çertifikata transporti) etj .

Zëri “**Materiale dhe shërbime speciale**” është realizuar në vlerën prej **344 mije leke** i

detajuar si më poshtë:

- Zëri “**Uniforma**” i parashikuar për blerje të uniformave të policisë bashkiake, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 333 date 02. 06. 1998 për “Miratimin e normës së veshmbathjes për policinë” për kostume, pantallona verore, xhakovento, këmisha, këpucë, pulovra, stema doreza pune etj nuk është realizuar. (*nuk eshte shpenzuar per blerje uniforma gjate vitit 2015*)
- Zëri “**Materiale te tjera**” i parashikuar për rimbushje fikëse zjarri dhe blerje materiale të ndryshme pune është realizuar në vlerën prej **344 mije leke**.

Zëri “**Shërbime**” është realizuar në vlerën **10 132 mije leke** i detajuar si më poshtë:

- ✓ Zëri “**Energji elektrike**” është realizuar në vlerën prej **3 141 mijë lekë** për shërbimin e furnizimit me energji për godinën e Bashkisë , zyrat e ndihmës ekonomike dhe zyrat e rajoneve 4 dhe 5 tek ish-Divizioni.
- ✓ Zëri “**Uje**” i parashikuar për shpenzime uji, është realizuar në vlerën prej **413 mije leke** për shërbimin e furnizimit me ujë të ambienteve të administrates së Bashkisë , zyrat e ndihmës ekonomike e zyrat e rajoneve administrative nr.4 e nr. 5 tek ish-Divizioni
- ✓ Zëri “**Telefon**” i parashikuar për shpenzimet për telefoninë celulare për titullarët në bazë të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. 864, dt 23. 07. 2010 si dhe telefoninë fikse për titullarët drejtoritë dhe 5 rajonet është realizuar në vlerën prej **412 mijë lekë** .
- ✓ Zëri “**Postare**” i parashikuar për shpenzime shërbime telegrafike e postare si edhe shpenzime kompensimi nga ana e Bashkisë për pagesë komisioni për shërbimin që ofrohet nga Posta Shqiptare SH. A Filiali Shkodër në marrjen e shtesës së kempit të invalidëve të punës dhe familjeve përfituese të ndihmës ekonomike është realizuar në vlerën prej **782 mije lekë**.
- ✓ Zëri “**Lëndë djegëse** ” i parashikuar për shpenzimet për gaz për ngrohje dhe gatim sipas kërkesave të paraqitura nga drejtoritë dhe institucionet e varësisë si Zyra e Arsimit (shkollat e mesme, shkollat 9

vjeçare, kopshtet, konviktet e shkollave të mesme profesionale, shkolla speciale 3 Dhjetori) , Drejtoria e Çerdheve (për gatim në 4 çerdhe) është realizuar në vlerën prej 3 000 mije lekë

- ✓ Zëri “**Shërbime të printimit dhe publikimit** ” realizimi është në vlerën prej 44 mije lekë per njoftimet zyrtare, urimet për raste festash, reklama për kalendare aktivitetesh etj.
- ✓ Zëri “**Shërbime të tjera**” i parashikuar për shpenzimet për shërbim interneti, shërbim i faqes Eëb, mirëmbajtjen e moduleve ekzistuese për Z1N, pagesë tarifa shërbimesh pranë ZVRPP shërbime për konfigurime softvare,e-mail dhe sms serveri, shpenzime vaksinime për qentë e rrugës etj është realizuar në vlerën prej 2 340 mijë lekë.

Zëri “**Shpenzime transporti** ” është realizuar në vlerën prej 5 380 mije leke i detajuar si më poshtë:

- Zëri “**Shpenzime karburanti**” i parashikuar per vitin 2015 është realizuar në vlerën prej 4 998 mije leke per shpenzimet per blerje karburant si per automjetet e Administrates, Drejtorisë së Shërbimeve Publike (autovinçi i sektorit të ndriçimit dhe makinës së vizimit), Drejtorisë së të Ardhurave, Policisë Bashkiake, Inspektoriatit Ndërtimor, motogeneratorit etj. Gjithashtu është realizuar ngrohja me kaldajë e 2 konvikteve të shkollave “Safet Spahia” dhe “Prenkë Jakova , për kaldajën e kopshtit “Bep Tusha”, për shkollën 9- vjeçare “Ali Laçeçj”, shkollën Speciale “3 Dhjetori” dhe shkollën Artistike “Prenkë Jakova”, automjetin e Zyrës së Arsimit, që bën shpërndarjen e ushqimeve në kopshte e çerdhe dhe për automjetin e shkollës Speciale “3 Dhjetori” i cili transporton personat që frekuentojnë këtë shkollë, të parashikuara nga Zyra e Arsimit për vitin 2015. Për Teatrin “Migjeni” është realizuar ngrohja me kaldajë në rastet e shfaqjeve të zhvilluara gjatë vitit. Për Sportklub “Vllaznia” janë bërë shpenzime karburanti për aktivitetet e çiklizmit për të rritur, çiklizmit për të rinj, për atletikën, gjeneratorin etj.
- Zëri “**Pjese kembimi**” është realizuar në vlerën prej 74 mije lekësh ,ku u perfshinë shpenzimet për automjetet si goma, bateri etj.
- Zëri “**Siguracion** “ i parashikuar për siguracionet e makinave të administratës, policisë bashkiake ,inspektoriatit ndërtimor, drejtorisë së të ardhurave dhe autovinçit është realizuar në vlerën prej 308 mije lekë.

Zëri “**Shpenzime udhetimi**” i parashikuar për realizimin e shpenzimeve të udhetimit të punonjësve , të cilët morën pjesë në aktivitete të ndryshme

kombëtare si konferenca, marrëveshje, takime pune etj është realizuar në vlerën prej **41 mijë lekë**.

Zëri "**Mirembajtje e zakonshme**" realizimi është në vlerën prej **320 mijë lekë** i detajuar si më poshtë:

- Zëri "**Mirembajtje per aparate paisje teknike**" i parashikuar për mirëmbajtje aparate teknike si riparime skanera/pc/fotokopje, printera etj realizimi është në vlerën prej **83 mijë lekë**.
- Zëri "**Shpenzime te tjera**" i parashikuar për riparimet e avarive të makinave në funksion të administratës, policisë bashkiake, inspektoriatit ndërtimor, drejtorisë së të ardhurave, motor gjeneratorit dhe mjeteve të shërbimeve publike: autoshkallës, elektrovinçit, makines se vizimit, prereses etj është realizuar në vlerën prej **237 mijë lekë**.

Zëri "**Qera objekte**" realizimi për vitin 2015 është në vlerën prej **60 mijë leke** per qera strehimi të familjeve në nevojë, me kushte të veçanta.

Zëri "**Detyrime dhe kompensime legale**" i parashikuar nga Drejtoria Juridike për planifikimin e borxheve të Bashkisë Shkodër ndaj të tretëve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të trashëguara dhe vendime gjyqësore në proces , me qëllim përmbushjen e ketyre detyrimeve të formës së prerë është realizuar në vlerën prej **1 mijë lekë**.

Zëri "**Shpenzime të tjera operative**" është realizuar në vlerën prej **10 483 mijë leke** i detajuar si me poshte:

- Zëri "**Aktivitete të ndryshme**" është realizuar në vlerën prej **200 mijë lekë** për lftarin e shtruar nga bashkia me pjesëmarrjen e drejtuesve dhe punonjësve të Komunitetit Mysliman të Shkodrës, përfaqësues nga Myftinia , përfaqësues të spektrit politik, punonjës të Bashkisë etj.
- Zëri "**Siguracion ndertese**" është realizuar në vlerën prej **424 mijë lekë**. Është bërë sigurimi i godinës së Bashkisë (zyrat) dhe sigurimi i magazinës së Bashkisë. Ky sigurim është bërë për rastet e ndodhjes së ngjarjeve nga zjarri dhe rreziqeve të tjera shtesë.
- Zëri i shpenzimeve për "**Honorare dhe shpenzime kompensimi**" është realizuar në vlerën prej **9 181 mijë lekë**, në përputhje me VKM nr.1619, datë 02.07.2008, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve te pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", ndryshuar me V.K.M Nr.518, datë 16.08.2012, ndryshuar me VKM Nr. 586, date 17.07.2013

që rregullon efektet e masës së shpërblimit për zyrtaret e zgjedhur dhe shpenzimet e honorareve për kryepleqtë i ndarë : shpenzime kompensimi për anëtarët e zgjedhur (këshillit bashkiak) në vlerën prej 7 839 mije lekë dhe honorare për kryepleqtë në vlerën prej 1 342 mije lekë.

- Zëri “ **Të tjera materiale e shërbime operative**” është realizuar në vlerën prej 678 mije lekë, të cilat janë realizuar për të mbuluar shpenzimet për blerje dhurata, fishekzjarre për festa , kurora dhe buqeta me lule etj.

Zëri “**Investime** “ është realizuar në vlerën prej **911 mije leke**, nga këto janë realizuar për “Hidroizolim tarraca e garazhit të Bashkisë” 168 mijë lekë, , “Blerje paisje operationale” 660 mijë lekë, për blerje paisje TIK, dhe “Blerje pajisje zyre” 83 mijë

DREJTORIA E KOORDINIMIT PROJEKTEVE DHE MARRDHENIEVE NDERKOMBETARE.

000/leke

Nr	EMERTIMI	Plani 2015	Realizimi 2015
I	Paga	2698	2530
II	Sigurime Shoqerore	429	423
III	Shpenzime Operative	850	797
IV	Investime	0	0
Totali		3977	3750

Shpenzimi për « **Paga** » për vitin 2015 është realizuar vlera prej **2530 mije leke**, për « **Sigurime shoqërore** » vlera prej **423 mije leke**, për « **Shpenzime operative** » vlera prej **797 mije leke**.

Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli është bazuar tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë , në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Paga, shtesat mbi pagat e punonjësve janë bërë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1619, datë 02.07.2008, “Për klasifikimin e funksioneve,



grupimin e njësisive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, ndryshuar me V.K.M Nr.518, datë 16.08.2012, ndryshuar me VKM Nr. 586, datë 17.07.2013.

Shpenzime operative

000/leke

Nr	Emertimi i shpenzimeve	Plani 2015	Realizimi 2015
6022	Sherbime	50	0
6029	Shpenzime te tjera operative	800	797
Totali		850	797

Më poshtë është analiza e shpenzimeve sipas grupeve dhe në mënyrë analitike:

- Zëri “**Kancelari**” « **Shpenzime operative** » është planifikuar shuma **800 mije leke** për “**Pritje percjellje**” për vitin 2015 dhe janë shpenzuar **797 mije leke**.
- ✓ Zëri “**Postare**” i parashikuar për shpenzime shërbime telegrafike e postare është planifikuar shuma **50 mije leke** është realizuar në vlerën prej **0 mije lekë**.

Gjatë vitit 2015 është vazhduar me implementimin e projekteve ekzistuese si dhe prezantimi i propozimeve të reja për financim nga donatorët e huaj, kryesisht BE.

Në Shkurt 2015, në Sardegnia, Itali është mbajtur aktiviteti III i projektit EUROMIGMOB, projekt ky i financuar nga BE (Europe for Citizens) ku Bashkia Shkodër ishte në rolin e liderit të projektit.

Konkretisht, në Mars 2015 ka mbaruar implementimi i projektit “Ndricimi i rrugës nga ish fabrika e çimentos deri në Shirokë”, projekt i financuar nga RDP Northern Albania.

Po në Mars 2015 është mbyllur projekti “Zhvillimi i turizmit në lumin Buna dhe liqenin e Shkodres” me të njëjtin donator.

Në Prill 2015, në Shkodër, është mbajtur aktiviteti IV dhe përmblyës i projektit EUROMIGMOB, projekt ky i financuar nga BE (Europe for Citizens) ku Bashkia Shkodër ishte në rolin e liderit të projektit. Ky projekt kishte si qëllim krijimin e një rrjeti të autoriteteve lokale në europë për të diskutuar qështje të migrimit. Në projekt morën pjesë 23 partnerë nga Italia, Hungaria, Shqipëria dhe Franca. Janë

realizuar 4 aktivitete ndërkombëtare (Massafra IT, Shkoder AL, Quartu Sant Elena IT, Shkoder AL) me pjesëmarrjen e me shume se 100 aktoreve te pushtetit local, shoqërisë civile në vendet përkatëse.

Në Maj 2015 Bashkia Shkoder u bë firmëtare e “Pledged to Peace” një nisëm e Bashkimit European për promovimin e paqes ku sheh si aktor dhe faktor pushtetin local për promovimin e paqes. Në qytetin Mazzara del Vallo në Itali, u organizua ceremonia e firmosjes së paktit ku Bashkia Shkodër u bë firmëtarja e rradhës duke u angazhuar kështu në promovimin, ndërtimin dhe ruajtjen e paqes.

Në kuadrin e përgatitjes së projekt propozimeve të reja për tu paraqitur për financim nga donator të huaj, DKPMN ka përgatitur dy partneritete në programet INTERREG-MED të Bashkimit European. Projekti i parë titullohet HOSPITIS dhe ka si qëllim promovimin e fshatrave bregdetar, ky projekt është prezantuar në bashkëpunim me Borghi Autentici, një OJF Italiane e cila ka bashkëpunuar prej vitesh me Bashkinë Shkodër. Projekti i dytë titullohet “BLUE HUBS – Innovation driven integrated smart eco ports Med netëork” dhe ka qëllim promovimin e eko-porteve, ky project është realizuar në bashkëpunim me Bashkinë Milazzo në Itali.

DREJTORIA JURIDIKE DHE ASETET

Mbështetur në buxhetin e vitit 2015 dhe ndryshimeve të bera gjate vitit sipas vendimeve të Keshillit Bashkisë Shkoder, nga Drejtoria e Juridike, Prokurimeve dhe Zyra e Aseteve për vitin 2015 ka realizuar si vijon :

I - Zyra Juridike Gjate kesaj periudhe ka siguruar dhenien e konsulences se nevojshme ligjore per te gjitha drejtorite dhe institucionet e varesise së Bashkise Shkoder, ka qene pjesmarrese ne disa procese gjyqesore per te perfaqesuar institucionin ku ajo ka qene pale ne proces, ka qene pjesmarres në disa komisione eshte hartuese e urdherave te brendshem, urdheresave, projekt vendimeve, akt-marreveshjeve, kontratave te qirase, kontratave te siper marrjes, supervizimeve, kolaudimeve. Kjo veprimtari eshte bere ne perputhje me dispozita ligjore kryesore.

Ka marre pjese aktive ne komisionet e shpronesimit te qirave dhe privatizimit te banesave shteterore si dhe komisionet e vlerësimit.

Ka nënshkruan dhe kontrolluar bazueshmerine ligjore te projekt-vendimeve për tu miratuar nga Keshilli Bashkiak sipas drejtorive perkatese.

Zyra juridike ka realizuar 2 (dy) kontrata qeraje, nga ku;

- Jane arketuar vlefte prej 1 148 460 leke nga qera objekti.

Ka shqyrtuar 5 raste duke bashkerenduar punen me komisionin ne zbatim te VKM 608 dt.05.09.2012 "Per paisje me certifikate pronsie".

Ka bashkerenduar punen me njesite administrative per paraqitjen dokumentacionit ne mbeshtetje te VKM nr.510 date 10.06.2015 .

Ka hartuar dokumentacionin e shpronsimit per 11 raste duke bashkerenduar punen me komisionin ne zbatim te VKM-ve perkatese.

Në zbatim te VKM 510 dt.10.06.2015 dhe VKM 664 dt.29.07.2015, ka konkluduar per paraqitjen e relacionit per shlyerjen të disa detyrimeve të Bashkisë Shkodër ndaj të tretëve të cilat rrjedhin nga procese gjyqsore, si bashkim i ish njërive që shkrihen, ne vleften prej **16 663 317 lekë**, te cilat jane miratuar me VKB nr. 25 datë 24.10.2015 "Për miratimin e likujdimit të disa detyrimeve të Bashkisë Shkodër ndaj të tretëve të cilat rrjedhin nga procese gjyqësore si bashkim i ish njërive që shkrihen".

Zyra juridike për vitin 2015 ka perfaqesuar në 115 procese gjyqësore civile/administrative me objekte gjykimin të ndryshme.

<i>Proçese në vijim në Gjykatën e shk.I, sh.II –të.</i>	<i>Proçese në vijim në Gjykatën e Lartë</i>	<i>Proçese të pushuara</i>	<i>Proçese të formës së prerë</i>
84	7	19	12

II- Zyra prokurimeve

Ka bashkerenduar punen me njesite administrative dhe hartuar rregjistrin e parashikimeve publike per Bashkine Shkoder

Ka bashkerenduar punen me njesite administrative dhe hartuar rregjistrin e realizimeve te prokurimeve publike per Bashkine Shkoder

Gjate vitit 2015 nga Zyra e Prokurimeve Publike, mbeshtetur ne fondet e miratuara sipas buxhetit te Bashkise Shkoder per vitin 2015, buxhetit te shtetit dhe VKB-ve perkatese, gjate vitit ka realizuar 209 procedura prokurimit, në vleften totale 354 115 435 leke, nga të cilat:

<i>Procedura prokurimi pune civile</i>	<i>Procedura prokurimi sherbime</i>	<i>Procedura prokurimi mallra</i>	<i>Procedura prokurimi me vlera te vogla</i>
247 276 509 leke	4 980 034 leke	65 399 158 leke	36 459 734 leke

III Zyra Aseteve

Sektori i Aseteve ka ushtruar aktivitetin për:

A. Proçesin e tansferimit të pronave në njësine e qeverisjes vendore, mbështetur në dispozitat ligjore:

Me VKM nr. 421, datë 2. 06. 2010 “ Për miratimin e listes përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodres“ pronat që kalohen në pronësi të Bashkisë Shkodër janë si më poshtë:

Në pronësi të Bashkisë Shkodër janë transferuar 236 prona, dërguar për regjistrim në ZVRPP Shkodër 162 prona, rregjistruar 53 prona dhe mbetet pa rregjistruar nga pronat e dërguara 109 prona.

Janë zbatuar të gjitha Vendimet e Këshillit të Ministrave për pronat.

Gjatë punës sonë jemi ndeshë në vështëri për regjistrimin e pronave dhe kemi dërguar shkresa të ndryshme për zgjidhjen e këtij problemi duke kërkuar bashkëpunimin e ZVRPP Shkodër, si dhe është informuar Zyra Qendrore e regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë e cila me shkresa të ndryshme drejtuar ZVRPP i kërkon urgjentisht me marrjen e masave për regjistrimin e këtyre pronave.

B. Procesin e kërkesave për shpronësime të cilat kanë dalë nga Rikonstruksioni I rrugëve të qytetit të Shkodrës., mbështetur në dispozitat ligjore :

- Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”

Gjatë vitit 2015 është përgatitur dokumentacioni për kryerjen e procedurave paraprake të shpronësimeve të pronarëve të pasurive pronë private që janë prekur nga rikonstruksioni I rrugëve të mëposhtme.

1. Rikonstruksion rruga Shkodër - Shirokë sheshi I Shirokës
2. Rikonstruksion Rruga 1 Qershori
3. Rikonstruksion rruga Shaban Bushati
4. Sistemim blloku i pallateve Qafe – Hardhi
5. Rikonstruksion rruga Ismail Lulani
6. Sistemim Sheshi para Zyres së Punes

Janë përgatitur projekt vendimet përkatëse dhe marrë miratimi I Këshillit bashkiak për këto shpronësime.

Me shkresën nr. 3140 prot, datë 27.5.2015 është dërguar në ministrinë e Punëve të brendshme “Kërkesa për shpronësim” , për objekti që do të shpronësohet Truall për “Rikonstruksion I rrugës Shkodër- Shirokë dhe sheshi Shirokë”

- **Fondi për shpronësim** miratuar me vendime të Këshillit bashkiak ndarë sipas rrugëve është si më poshtë:

1. Sistemim blloku I pallateve Qafe – Hardhi	608 702	lekë
2. Rikonstruksion rruga Shaban Bushati	3 400 000	lekë
3. Rikonstruksion rruga Ismail Lulani	148 620	lekë
4. Rikonstruksion Rruga 1 Qershori	1 684 360	leke
5. Sistemim blloqe banimi Zogu i I-re ,krahu i djathte (Zyra e Punes,Drejtoria e Bujqesise)	413 610	leke

